



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR MAT

Nr. _____ Prot.

Burrel, më 18/ 02/ 2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

Për: Operatorin Ekonomik: “GLOBAL SECURITY” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K72217015V.

Adresa: lagja “Partizani”, sheshi “Demokracia”, Ndërtesë private Nr.11, Burrel, Dibër.

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim**, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: **REF-03910-01-15-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Shërbimi i Sigurimit dhe Ruajtjes fizike” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj**, me fondin total: **3,380,064.⁴⁴** (tre milion e treqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH,

Fondi limit për një vëndroje/ mujore – 281,672.⁰⁴ lekë pa TVSH
me afat realizimi të kontratës: **12 (dymbëdhjetë) muaj**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet)

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 03, datë 21 Janar 2019**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **Çmimi më i ulët**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria **“GLOBAL SECURITY” Sh.p.k,** me numër Nipt-i: **K72217015V,**
Me vlerë të ofertuar: **3,158,918.38** (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
Vlera e ofertuar për një vëndroje/ mujore – **263,243.²⁷ lekë pa TVSH**
2. Shoqëria **“KURTI SECURITY” Sh.p.k,** me numër Nipt-i: **L38011902R,**
Me vlerë të ofertuar: **3,158,287.68** (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Vlera e ofertuar për një vëndroje/ mujore – 263,190.⁶⁴ lekë pa TVSH

3. Shoqëria “RES-03” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K26513468E,

Me vlerë të ofertuar: 3,158,918.28 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

Vlera e ofertuar për një vëndroje/ mujore – 263,243.¹⁹ lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “KURTI SECURITY” Sh.p.k, me numër Nipt-i: L38011902R,

2. Shoqëria “RES-03” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K26513468E,

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, shoqëria “KURTI SECURITY” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

1. Nuk përmbushet pika 4/ 2.1 Kapaciteti ligjore i operatorve ekonomik/ Kri­teret e Veçanta të Kualifikimit :

4. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 13 (trembëdhjetë) punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Dibër, konform ligjit nr. 75/2014, datë 10.07.2014, të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

- Ky kriter nuk përmbushet, pasi nuk disponohen 13 punonjës shërbimi të çertifikuar, por vetëm 10 punonjës.

2. Nuk përmbushet pika 2/ 2.3 Kapaciteti Teknik/ Kri­teret e Veçanta të Kualifikimit :

2. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën vitin 2018, për një numër punonjësish jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore, dhe listëpagesat përkatëse.

- Ky kriter nuk përmbushet, pasi numri i të siguruarve për muajt Janar – Tetor 2018 është më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë), respektivisht për muajt: Janar - 11 (njëmbëdhjetë); Shkurt - 13 (trembëdhjetë); Mars - 13 (trembëdhjetë); Prill - 12 (dymbëdhjetë); Maj - 12 (dymbëdhjetë); Qershor - 13 (trembëdhjetë); Korrik - 12 (dymbëdhjetë); Gusht - 12 (dymbëdhjetë); Shtator - 11 (njëmbëdhjetë); Tetor - 13 (trembëdhjetë).

3. Nuk përmbushet pika 4/ 2.3 Kapaciteti Teknik / Kri­teret e Veçanta të Kualifikimit:

4. Subjekti SHPSF duhet të paraqesë vërtetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e

Policisë së Qarkut Dibër në bazë të ligjit 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" 1.3A, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 mbi funksionimin e Shpsf-ve të lëshuar jo më parë se dy muaj nga dita e hapjes së ofertave nëpërmjet të cilit të jepet informacion mbi:

- *Numrin e punonjësve të shërbimit të çertifikuar, jo më pak se 13 punonjës të çertifikuar në bazë të ligjit 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike,"*
- *Numrin e përgjegjësve të shërbimit, jo më pak se 1 punonjës për garantimin dhe kontrollimin e shërbimit të çertifikuar në bazë të ligjit 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 mbi funksionimin e SHPSF-ve;*
- *Numri i grupit të gatshëm dhe i operatorëve të qendrës së kontrollit në Vërtetimin e Performancës duhet të jetë sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për gadishmërinë në shërbim sipas rastit, në bazë të ligjit 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike,"*
- *Numrin e radiove të dorës, jo më pak se 3 copë për vendrojen dhe një për grupin e gatshëm*
- *Të mos ketë ngjarje dhe masa administrative gjatë 3 viteve të fundit, si dhe të ketë shlyer detyrimet ndaj DVP Dibër për 2016-2017-2018.*
- *Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF-së të jetë shumë e mirë.*

Në rast bashkimi operatorësh ekonomik secili operator duhet të plotësojë këtë kriter sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Të gjitha mjetet speciale të jenë të vërtetuara me anë të faturave tatimore dhe likuidimin bankar përkatës. Aramtimi me anë të kontratave të shit/blerjes dhe faturat bashkë me likuidimet përkatëse

- Bazuar në Vlerësimin e Performancës të D.V.P.Dibër, ky kriter nuk përmbushet nga operatori ekonomik, pasi:

1. Nuk disponon 13 punonjës shërbimi, por vetëm 11 punonjës
2. Nuk jepet informacion mbi numrin e përgjegjësve të shërbimit
3. Nuk jepet informacion për numrin e operatorëve të qendrës së kontrollit
4. Nuk jepet informacion mbi numrin e radiove të dorës.

4. Nuk përmbushet pika 7/ 2.3 Kapaciteti Teknik / Kritere e Veçanta të Kualifikimit:

7. Operatori Ekonomik ofertues në zbatim të ligjit nr. 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"neni 22 i tij, duhet të ketë në stafin teknik 1 (një) inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni me kontratë pune. Për inxhinierin duhet të paraqitet Diploma, Kontrata e Punës i cili është i nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës dhe sistemin e alarmit.

- Ky kriter nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk ka të punësuar një punonjës Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, shoqëria **“RES-03”** Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, **rezulton se nuk përmbush dokumentacionin e kërkuar në**

përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

1. Nuk përmbushet pika 3/ 2.3 Kapaciteti Teknik/ Kriteret e veçanta të kualifikimit:

3. Subjekti SHPSF duhet të paraqesë autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi në emër të tij, e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës, për Qytetin e Burrelit.

- Ky kriter nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi Autorizimi Individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi në emër të tij, **nuk është** i vlefshëm për periudhën e zbatimit të kontratës, për Qytetin e Burrelit.

2. Nuk përmbushet pika 6/ 2.3 Kapaciteti Teknik/ Kriteret e veçanta të kualifikimit:

6. Subjekti SHPSF duhet të provojë se disponon 2 automjete për të përmbushur objektin e kësaj kontrate si më poshtë:

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin çertifikatë pronësie e automjetit, leje qarkullimi, siguracioni, kontrolli teknik dhe taksat.*
- *Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerasë si dhe dokumenti që vërteton regjistrimin çertifikatë pronësie e automjetit, leje qarkullimi, siguracioni, kontrolli teknik dhe taksat.*

- Ky kriter nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk disponon 2 automjete, por vetëm 1 automjet

Public Health Sector

3. Nuk përmbushet pika 7/ 2.3 Kapaciteti Teknik/ Kriteret e veçanta të kualifikimit:

7. Operatori Ekonomik ofertues në zbatim të ligjit nr. 75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"neni 22 i tij, duhet të ketë në stafin teknik 1 (një) inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni me kontratë pune. Për inxhinierin duhet të paraqitet Diploma, Kontrata e Punës i cili është i nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës dhe sistemin e alarmit.

- Ky kriter nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk ka të punësuar një punonjës Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacioni

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“GLOBAL SECURITY”** Sh.p.k, me seli: lagjja “Partizani”, sheshi “Demokracia”, Ndërtesë private Nr.11, Burrel, Dibër; me numër Nipt-i: **K72217015V**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: : **3,158,918.38** (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pikë tridhjetë e tetë) **lekë pa**

TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat** me adresë: lagja “Drita”, Rr. “Ibrahim Temo”, Burrel, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **08.02.2019**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i autoritetit kontraktor

